



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Kryesia e Kuvendit

P-010

Prishtinë, më 7 dhjetor 2017, në orën 14:45

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 DHJETOR 2017

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Elmi Reçica, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 20, 23 dhe 29 nëntor 2017.

### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 14 dhjetor 2017, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,*
5. *Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016,*
6. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016,*
7. *Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës vjetore për vitin 2018,*
8. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,*
9. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.*

### 3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

*1. Nisma legislative e Projektligjit për Miniera dhe Minerale, e hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal*

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën Legjislative “Projektligji për miniera dhe minerale”, si dhe të përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një muaji nga dita e pranimit.

*2. Propozimi i Komisionit për Punë të Jashtme për formimin dhe riformimin e grupeve të miqësisë në fillim të mandatit të ri parlamentar*

Kryetari lidhur me propozimin e lartshënuar konstatoi se pasi të procedohen propozimet e emrave të deputetëve, Kryesia do të vendosë për formimin e grupeve të miqësisë.

*3. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Sala Berisha-Shala dhe Hykmete Bajrami, u lejohet udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në takimet e Plenumit Parlamentar të Komitetit të Energjisë dhe në Forumin Parlamentar të Evropës Juglindore “Eficienca e energjisë dhe klima”, të cilat do të mbahen në Vjenë (Austri), nga 18-20 dhjetor 2017.

2. Shpenzimet lidhur me realizimin e këtij udhëtimit zyrtar për të lartpërmendurit në pikën një (1) të këtij vendimi do të mbulohen sipas kërkesës nr. 06/292/Do-211, datë 20. 11. 2017.

*4. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hungari*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vjosa Osmani-Sadriu, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Visar Ymeri, u lejohet udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në takimet e radhës të Grupit të Vishegradit, që do të mbahen në Hungari, nga 12-15 dhjetor 2017.

2. Shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi zyrtar për të lartpërmendurit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen sipas kërkesës nr. 06/304/Do-215, datë 21. 11. 2017.

*5. Kërkesa e katër (4) deputetëve për lejimin e pjesëmarrjes në Lutjet Kombëtare të Mëngjesit në SHBA*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj dhe Slobodan Petroviq, u lejohet udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në Lutjet e 66-ta të Mëngjesit, në Uashington D. C. (SHBA), prej 4-9 shkurt 2018.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi zyrtar për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas kërkesës nr. 06/327/Do-231, datë 27.11.2017.

*6. Kërkesa e deputetes Vjosa Osmani-Sadriu për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, si dhe mori këtë:

## V E N D I M

1. Kryetares së Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani-Sadriu, i lejohet udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në Forumin Ndërparlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Inteligjencës, i cili do të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga 6-8 dhjetor 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

*7. Kërkesa e deputetit Slobodan Petroviq për emërimin e tij anëtar me të drejta të plota në Komisionin Parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

I propozohet seancës plenare që ta ndryshojë dhe plotësojë vendimin nr. 006, datë 3. 10. 2017, pika I.b) Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim të plotësohet edhe me tre (3) anëtarë: një (1) anëtar nga GP “Nisma për Kosovën”; z. Slobodan Petroviq nga komuniteti serb; një (1) anëtar nga komunitetet tjera joshumicë.

*8. Kërkesa e ish-drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Hasan Preteni, për kompensimin e pagës kalimtare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk e miratoi kërkesën e z. Hasan Preteni, ish-drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për kompensimin e pagës kalimtare pas përfundimit të mandatit të tij.

*9. Kërkesa për lejimin e shpenzimeve të tejkaluara lidhur me vizitën zyrtare të realizuar nga pesë (5) deputetë të Kuvendit në Belgjikë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet kërkesa për kompensimin e tejkalimit të shpenzimeve të akomodimit të deputetëve: Fitore Pacolli, Fidan Rekalii, Evegjeni Thaç-Drangusha, Bekë Berisha dhe Bahrim Shabani lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel (Belgjikë), prej 19-22 nëntor 2017, sipas kërkesës me nr. 06/342/DO-243, datë 1. 12. 2017.

*10. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 - 31 dhjetor 2017*

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Radiotelevizionit të Kosovës për transferin e mjeteve për muajin dhjetor 2017 dhe rekomandimin e bërë Ministrisë së Financave, respektivisht drejtorit të përgjithshëm të Thesarit për transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së, nr. 1110101219060187, për periudhën 1 - 31 dhjetor 2017, në shumën prej 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) euro.

*11. Njoftimi i z. Hajdar Beqa, zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Legjislacion lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani*

Kryesia u njoftua me shkrim nga z. Hajdar Beqa, zëvendëskryetar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Berlin (Gjermani), nga 20-22 nëntor 2017.

*12. Kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivkoviq, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhavahire Izmaqu, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli, u lejohet udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), nga 11-12 dhjetor 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit zyrtar për të lartpërmendurit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës sipas kërkesës nr. 06/365/Do-258, datë 7. 12. 2017.

*13. Kërkesa e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit: Hajdar Beqa, Korab Sejdiu, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Bilall Sherifi, Bahrim Shabani dhe Igor Simiq, si dhe Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i Kuvendit u lejohet udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), nga 18-20 dhjetor 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit zyrtar mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës sipas kërkesës nr. 06/366/Do-259, datë 7. 12. 2017.

#### **4 . Të ndryshme**

*1. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Xhavit Haliti, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për delegacionin e Kuvendit të Shqipërisë në Këshillin e Evropës, që do ta vizitojë Kosovën*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për delegacionin nga Kuvendi i Shqipërisë në Këshillin e Evropës, që do ta vizitojë Kosovën nga 17-18 dhjetor 2017.

*2. Kërkesa e z. Avdullah Hoti, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, për punësimin e një asistenti(e) administrativ(e) të këtij grupi deri në kthimin e asistentes nga pushimi i lehonisë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

Lejohet punësimi i një asistenti(e) administrativ(e) në Grupin Parlamentar të LDK-së deri në kthimin e asistentes nga pushimi i lehonisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*